



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 13.11.2019

VENDIM

Nr. 61, datë 13.11.2019

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "DREJTËSI" NË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, "MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI", NË UNIVERSITETIN 'ISMAIL QEMALI', VLORE

Mbështetur në shkronjën **b** të pikës **3** në nenin **75**, nenin **82**, shkronjën **dh** të pikës **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën **f** të pikës **2** në kreun **III** të VKM-së nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.11.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Drejtësisë me nr. 348 prot., datë 12.11.2019 për riorganizim të programit "Bachelor" në "Drejtësi" në program të integruar të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave" në "Drejtësi" në përshtatje me ndryshimet ligjore që parashikojnë riorganizimin e këtij programi studimi nga program i ciklit të parë të studimeve me 180 kredite në program të integruar studimi të ciklit të dytë me 300 kredite.
2. Ky program studimi parashikohet të zbatohet për vitin akademik 2020-2021 pas urdhrimit të miratimit nga MASR.
3. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Dr. Elenica BEQIRAJ (PJERO)

